


Dr.Shefqet Krasniqi

TEXHVIDI I
PREFERUAR
KUR'AN PËR
TË LEXUAR



Dr.Shefqet Krasniqi

TEXHVIDI I PREFERUAR KUR'AN PËR TË LEXUAR

Prishtinë
2006

Recesent:
Osman Abazi

Lektoroi:
Ylldije Sulka

Përgatitja kompjuterike:
Jeton Svirca

Kopertina:
Jeton Svirca

Botues:
Shtëpia Botuese Krenaria

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Parathënie

Falënderojmë Allahun e madhëruar që zbriti Kuranin fisnik dhe që nëpërmjet tij e nxori njerëzimin nga errësira në dritë. Allahu xh.sh thotë:

" قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ "

(Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë. Allahu e udhëzon (me Kuranin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e Tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë) (Elmaide 15-16).

Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të dërguarin e Tij, Muhamedin alejhi selam, i cili më së miri dhe më së shumti e lexoi Kuranin dhe, porositi që sa më shumë të lexohet Ai libër i shenjtë, duke premtuar shpërblim të madh për lexuesit e tij :

(يُقَالُ لَصَاحِبِ الْقُرْآنِ اقْرَأْ وَارْقُ وَرَتِّلْ كَمَا كُنْتَ تُرَتِّلُ فِي دَارِ الدُّنْيَا فَإِنَّ مِثْلَكَ عِنْدَ آخِرِ آيَةٍ تَقْرَأُهَا)

"Lexuesit të Kuranit I thuhet: lexo dhe ngrihu (lart), lexo ashtu si e ke lexuar në atë botë (me texhvid) sepse ti do të ngrihesh vazhdimisht duke e lexuar atë deri në ajetin e fundit ashtu si e ke lexuar në atë botë (në këtë jetë)".

Gjithashtu përshëndetje, salavat i dërgojmë të gjithë muslimanëve të sinqertë prej kohës së Pejgamberit të cilët kontribuan shumë në përhapjen e mësimave të Kur'anit.

Shkenca e Texhvidit është prej diturive me të cilën obligohet çdo besimtar musliman ta mësojë dhe

t'i kushtojë rëndësi të madhe sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me adhurimin, apo me një adhurim (ibadet) të kërkuar nga çdo musliman siç është leximi i Kur'anit sepse, çdo musliman obligohet që ta lexojë Kur'anin e madhëruar. Por Kur'ani i madhëruar nuk mund të lexohet në mënyrë të saktë dhe drejt pa njohjen e kësaj shkence.

Kur'ani kerim (fisnik) ka rrugën e vet të veçantë, apo mënyrën e vet nëpërmjet së cilës është përcjellë tek ne, me një përpikëri shumë të lartë, në maksimum e që është gojë pas goje. Pra, Kur'ani është përcjellë tek ne gojë më gojë.

Ai që e lexon Kur'anin, e merr prej mësuesit të vet në mënyrë gojore, pra nxënësi prej mësuesit të vet, duke dëgjuar njëri-tjetrin, e kështu me radhë, brez pas brezi deri tek ne, në ditët tona. Ashtu si Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem që e ka marrë Kur'anin prej Xhibilit alejhis-selam dhe Xhibili e ka dëgjuar prej All-llahut tebareke ve teala.

Emërtimi "Texhvid" do të thotë zbukurim në aspektin gjuhësor, ndërsa në aspektin terminologjik do të thotë zbukurim i leximit të Kuranit, duke e lexuar atë "muretel", me fjalë dhe lexim të qartë. Ky lexim duhet të jetë në mënyrë të tillë që, çdo shkronjë prej shkronjave të Kur'anit, ta lexojmë në mënyrë të saktë dhe të drejtë, pra duke i shqiptuar si duhet dhe duke pasur parasysh veçoritë e çdo shkronje, duke i ruajtur dispozitat e texhvidit si p.sh: Idhhari (shqiptimi i qartë), Idgami (shkrirje), Ihfa (fshehje), Medde (zgjatime), Gunne (tingull hundor), etj.., Pra duke e lexuar Kur'anin ngadalë dhe rrjedhshëm, duke zbukuruar zërin sa më shumë gjatë leximit me një melodi të mirë, por, jo duke e tepruar këtë mënyrë leximi.

Qëllimi i krejt kësaj shkence është që të lexohet Kur'ani në mënyrë profetike, të shëndoshë ashtu si i ka zbritur Pejgamberit alejhis-salatu ves-selam. Me këtë nënkuptohet se kur e lexon Kur'anin

me rregullat e texhvidit, e ke lexuar atë si e ka lexuar Pejgamberi alejhis-salatu ves-selam.

Mëshiruesi ynë, na ka urdhëruar që ta lexojmë Kur'anin me texhvid dhe për këtë, All-llahu az-ze ve xhel-l në Kur'an thotë:

"وَرَتَّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا"

"..dhe lexoje Kur'anin me tertil (si e meriton ai të lexohet, ashtu si edhe ka zbritur)". (Elmuzemil:4)

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

"لَيْسَ مِنَّا مَنْ لَمْ يَتَعَنَّ بِالْقُرْآنِ"

"Nuk është prej nesh ai që nuk e zbukuron zërin duke e lexuar Kur'anin e Madhëruar".

Pra, Texhvidi ka dobi të madhe sa i përket leximit të shëndoshë të librit të shenjtë, Kur'anit. Dhe pikërisht për këtë arsye, myslimanët çdo herë i kanë kushtuar kësaj shkence një rëndësi tepër të madhe dhe qysh në vegjëli ua kanë mësuar fëmijëve të tyre leximin e shëndoshë të këtij libri, me dispozitat e veta të cilat i përmbledh shkencë e Texhvidit.

Duke e lexuar kështu, ne afrohem tek All-llahu az-ze ve xhel-l, sepse leximi i Kur'anit është ibadet i madh për ne myslimanët, thot Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

"خَيْرُكُمْ مَنْ تَعَلَّمَ الْقُرْآنَ وَعَلَّمَهُ"

"Më i miri prej jush është ai, i cili, e mëson Kur'anin (për vete) dhe ua mëson atë të tjerëve". Po ashtu, Pejgamberi alejhis-salatu ves-selam lidhur me këtë ka thënë:

"الْمَاهِرُ بِالْقُرْآنِ مَعَ السَّفَرَةِ الْكِرَامِ الْبَرَةِ"

"Ai që është i shkathët në Kur'an, është në shoqëri të melekëve shëtites, fisnik dhe bamirës". Pra ai që e lexon Kur'anin me Texhvid dhe e zbukuron zërin e tij duke u munduar ta ruajë atë që e ka mësuar përmendësh dhe është i shkathët në lexim, mbajtjen përmendësh të Kur'anit, prezantimin e tij kurdo që ka nevojë për të, ai ka një shkallë shumë të lartë. Për këtë arsye, i pari që e ka lexuar Kur'anin me texhvid,

është Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke i mësuar Sahabët e vet. Dhe Sahabët i kanë mësuar nxënësit e vet, e, kështu derisa ka ardhur tek ne. Dhe leximi i Kur'anit, faktikisht mësimi i tij, është detyrë për ne dhe është mirësi ose sevap i madh, ka thënë alejhis-salatu ves-selam:

"اقْرَؤُوا الْقُرْآنَ فَإِنَّهُ يَأْتِي بِكُمْ الْقِيَامَةَ شَفِيعًا لِأَصْحَابِهِ"

"Lexoni Kur'anin sepse ai në Ditën e Kijametit do të vijë shëfatxhi (ndërmjetësues) për ata që e kanë lexuar atë". Ashtu sikurse edhe ka thënë:

" مَنْ قَرَأَ حَرْفًا مِنْ كِتَابِ اللَّهِ فَلَهُ بِهِ حَسَنَةٌ وَالحَسَنَةُ بِعَشْرِ أَمْثَالِهَا"

"Ai që lexon një shkronjë prej Librit të All-llahut (Kur'anit) ka për të një të mirë, dhe e mira shumëfishohet dhjetëfish (pra për çdo shkronjë nga dhjetë të mira (sevape)".

Pra, Texhvidi është shkencë me shumë rëndësi, pa mësimin e të cilit është i mangët ai që lexon Kur'an. Dhe mjerisht gjejmë njerëz që lexojnë Kur'an përditë. Ndoshta kanë mësuar përmendësh një numër të madh të sureve të Kur'anit, xhuzeve e ndoshta ka edhe hafiza të cilët e lexojnë Kur'anin, mirëpo nuk janë në gjendje ta shqiptojnë atë sipas rregullave të Texhvidit dhe faktikisht shkaktojnë të meta serioze të mëdha.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka kjo shkencë, e kërkesat e mëdha të disa fillestarve për një përmbledhje të tillë, dhe duke pasur dëshirë të madhe që të kontribuojmë sado pak me një punim modest, kemi vendosur ta bëjmë një libër të vogël që në të t'i përmbledhim rregullat dhe dispozitat më të nevojshme e leximit të drejtë, edhe pse këto dispozita natyrisht që janë shumë të mëdha dhe të gjera, mirëpo ne, në dashtë All-llahu subhanehu ve teala, do t'i cekim disa prej tyre të cilat janë më të shpeshta dhe më të nevojshme për ta lexuar Kur'anin e Madhëruar në mënyrë të tillë që të jemi

sa më afër origjinalit, ashtu si ka zbritur ai libër i shenjtë dhe si meriton të lexohet. Do të mundohemi ti spjegojmë ato me një metodë të thjeshtë dhe praktike duke mos e zgjatur por edhe duke mos e shkurtuar shumë, në mënyrë të tillë që mos të bëhet tepër i gjër, por as mos të jetë i pakuptuar nga shkurtesa, që ndoshta më shumë do t'iu kishte hyrë në punë fillestarëve, ndërsa për atë që do të zgjerohet më shumë, mund të kthehet në libra tjerë që e shtjellojnë këtë shkencë më gjërë. Dhe këtë libër e kemi quajtur:

TEXHVIDI I PREFERUAR KUR'AN PËR TË LEXUAR

Pas kësaj hyrjeje të shkurtër shkojmë tek rregullat kryesore të Texhvidit. Së pari fillojmë duke e lutur të madhin All-llah që të na ndihmojë duke na e bërë këtë punë të lehtë për hir të Madhërisë së tij dhe që me këtë t'i shpërblejë prindërit e mi të cilët kanë bërë shumë durim apo sabër për mua.
Amin!

DISPOZITAT E NUNIT ME SUKUN DHE TË TENVINIT

أَحْكَامُ النُّونِ السَّائِكَةِ وَالتَّنْوِينِ
(نْ ، نَ)

NUNI ME SUKUN DHE TENVINI

النُّونُ السَّاكِنَةُ وَالتَّنْوِينُ (ن، نِ)

عَفُورٌ، عَزِيزٌ، أَزْوَاجًا 2) .إِنْ، مِنْ، كُنْتُمْ، الْأَنْبِيَاءُ 1)
غَاسِقٍ

Në grupin e parë hasim Nunin me sukun. Ndërsa në grupin e dytë hasim tenvinin.

Nuni me sukun dhe tenvini kanë katër dispozita:

- 1-Idhhar (الإظهار)
- 2-Idgam (الإدغام)
- 3-Iklab (الإقلاب)
- 4-Ihfa (الإخفاء).

الْإِظْهَارُ - IDHHARI

SHPREHJE E QARTË

Idhhari: është rregulli i parë që do të thotë shqiptim (paraqitje, dukje) i Nunit me sukun apo të tenvinëve në mënyrë të qartë pa gunne (tingull hundor), ose thënë më thjeshtë, shqiptimi i tyre në atë mënyrë si shkruhen ose shënohen. Dhe kjo ndodh kur këto shfaqen para gjashtë shkronjave: (ه غ ع خ ح أ) الهَمْزَةُ، وَالْهَاءُ، وَالْعَيْنُ، وَالْحَاءُ، وَالْغَيْنُ، وَالْخَاءُ Hemzja (Elifi), Haun, Ajnun, Haun, Gajnun, Ha. Të bashkuara në fjalët:

أَخِي هَآكَ عِلْمًا حَازَهُ غَيْرُ خَاسِرٍ

Përmes shembujve kjo do të na sqarohet edhe më shumë:

1) Së pari shkronjat e Idhharit pas Nunit me sukun:

مَنْ أَمِنَ، مَنْ أُعْطِيَ، إِنْ أَرَدْتُمْ، مَنْ هَدَى اللَّهُ،
مَنْ هَادٍ، فَمَنْ حَاجَّكَ، مَنْ خَيْرٌ، مَنْ خَشِيَ،
فَإِنْ خِفْتُمْ، مِنْ عَمَلٍ، مِنْ غَيْرِكُمْ، مِنْ غَسَلِينَ،

2) Së dyti shkronjat e Idhharit pas tenvinit:

لَطِيفٌ خَبِيرٌ، لَأَيَّ يَوْمٍ أَجَلْتُ، سَلَامٌ هِيَ،
وَجَنَاتٍ أَلْفَافًا، لِكُلِّ قَوْمٍ هَادٍ، وَرَبُّ غَفُورٍ،
أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ، نَارًا خَالِدًا فِيهَا، وَاسِعٌ عَلِيمٌ

Pra, në të gjitha këto raste nuni me sukun dhe tenvinët duhet të shqiptohen ashtu siç janë, në mënyrë të qartë.

Shkaktari i Idhharit është: largësia e daljes (mahrexh) së Nunit dhe tenvinëve në krahasim me këto shkronja.

Kategoritë e Idhharit janë tri: më e larta është para Hemzes (Elifit) dhe shkronjës Ha (e lehtë), mesatarja është para shkronjës Ajn dhe Ha (e fytyrës pa grithje) dhe më e ulëta është te shkronja gajn dhe Ha (me grithje te grykës, hundës apo të dhëmbëve me buzët).

الإِدْغَامُ - IDGAMI

SHKRIRJA

(hyrje tek njëra - tjetra)

Idgam në aspektin gjuhësor do të thotë: depërtim e diçkaje apo shkrirje (të shkronjës në shkronjën tjetër).

Ndërsa në aspektin terminologjik do të thotë: shkrirja, futja e nunit me sukun dhe të tenvinëve në shkronjën e cila vjen pas tyre, në mënyrë të tillë që nuni me sukun dhe tenvinët nuk shqiptohen, por shqiptohet shkronja që vjen pas tyre me teshdid. Idgami ndodh

para gjashtë shkronjave: (ي و ن م ل ر)

الْيَاءُ، الرَّاءُ، الْمِيمُ، اللَّامُ، الْوَاوُ، الثُّونُ

Raun, lamun, mimun, nunun, vavun, jaun, të përmbledhura në fjalën (يَرْمُلُونَ).

Por megjithatë, katër shkronja prej tyre i shqipton me gunne (me tingull hundor) dhe quhen Idgam Nakis (shkrirje e mangët), e ato janë:

، الثُّونُ ، وَالْمِيمُ ، وَالْوَاوُ ، وَالْيَاءُ .

Ndërsa në dy prej tyre shqipton shkronjën që vjen pas tyre të dyfishuar, me teshdid, pa gunne dhe quhet Idgam Kamil (shkrirje e plotë), në:

Shembujt: اللَّامُ وَالرَّاءُ (ل ، ر)

مَنْ يَعْمَلْ (من يَعْمَلْ)، وَجُوهٌ يَوْمَنُذٍ (وَجُوهٌ يَوْمَنُذٍ)،

مِنْ وَلَدٍ (من وَلَدٍ)، خَيْرٌ وَأَبْقَى (خَيْرٌ وَأَبْقَى)،

مِنْ مَسَدٍ (من مَسَدٍ)، قَوْلٌ مَعْرُوفٌ (قَوْلٌ مَعْرُوفٌ)،

مِنْ نَذِيرٍ (من نَذِيرٍ)، كَلَّا نُمَدُّ (كَلَّا نُمَدُّ)

Ndërsa shembuj për اللام والراء që shqiptohen pa gunne:

أَنْ لَوْ، مَا لَأَلْبَدَا، مِنْ رَبِّهِمْ، غَفُورٌ رَحِيمٌ

Vërejtje: Nëse Nuni me sukun ndodh të jenë në të njëjtën fjalë atëherë nuk ndodh idgami, e këtë në Kur'an e gjejmë në katër fjalë, të cilat janë:

الدُّنْيَا، بُنْيَانٌ، قِنَوَانٌ، صِنَوَانٌ

Shkaktarë të Idgamtë janë: ngjashmëria, afërsia dhe lloji i njëjtë i këtyre shkronjave me Nunin, sukun dhe tenvinët.

الإِفْلَابُ - IKLABI

RROTULLIM - SHËNDËRRIM

Iklab në aspektin gjuhësor do të thotë: shëndrrim i një gjëje në një gjë tjetër (shëndrrimi i një shqiptimi në një shqiptim tjetër).

Ndërsa në aspektin terminologjik do të thotë: shëndrrim i nuni sukunit dhe tenvinit në shkronjën الميم Mim, dhe ajo ndodh para shkronjës Ba - الإِخْفَاءُ, pastaj atë e shqipton me fshehje الإِخْفَاءُ, por gjithmonë duke e ruajtur gunnen (tingullin hundor). Dhe nuk ka dallim mes asaj nëse është nuni me shkronjën "ba" الباء në një fjalë apo në dy. P.sh.

مَنْ بَعْدَ، أَنْ بُورِكَ

Pse ka ndodhur kjo: Iklabi ka ndodhur si shkak i vështirësisë së shqiptimit të gunnes në nun ن dhe tenvin me idhhar dhe si shkak i mbylljes së buzëve për arsye të shkronjës ba ب, si dhe për shkak të vështirësisë së shkrirjes (idgamtë) për arsye të ndryshimit të daljes së shkronjave dhe mospërshtatjes, kështu që përcaktohet ihfaja dhe rrotullim i nunit në Mim sepse ky e shoqëron Ba-në në dalje dhe tenvinin në gunne.

الإخفاء - IHFAJA

FSHEHJE (shqiptim jo i qartë)

Ihfa në aspektin gjuhësor do të thotë: mbulimi apo fshehja e diçkaje.

Ndërsa në aspektin terminologjik do të thotë: mbulim apo fshehje e shkronjës duke e ruajtur gunnen para shkronjave të ihfas, në mënyrë të tillë që të qëndrojnë mes idhharit dhe idgamit.

Për ta sqaruar më shumë këtë themi se:

IDHHARI: është ruajtja e shkronjës duke e shqiptuar atë ashtu si është, si shkruhet, duke e dalluar prej shkronjës e cila e pason, pra, pa e përzier shkronjën e parë me të dytën.

Ndërsa IDGAMI është: humbja apo asimilimi i shkronjës së parë (gjatë) (dhe) shqiptimit të saj dhe përzierja me shkronjën e dytë.

E ndërsa IHFAJA është në një shkallë të mesme mes dy shkallëve dhe në një pozitë mes dy pozitive, pra as nuk e ruajmë shkronjën ashtu si është; as nuk e shkrijmë në të shkronjën tjetër, por e përziejmë një pjesë të nunit në shkronjën e cila e pason dhe e ruan pjesën tjetër në shqiptim, kështu që kur ta shqiptosh nunin me ihfan, e nxjerr atë prej hunde. Pra, ihfaja është e afërt me idgamin në veçanti te shkronja

“vav” الواو dhe “ja” الياء, dallimi është se shkalla e përzierjes së nuni sukunit në shkronjën vijuese në idgam, është më e madhe sesa në ihfa, për këtë arsye e gjen teshdidin në idgam dhe nuk e gjen në ihfa.

Shkronjat e ihfasë: shkronjat e ihfasë janë të gjitha ato shkronja të cilat nuk u cekën në tri dispozitat e mëparshme - idhhar, idgam, iklab. Pra janë gjithsej 15 shkronja dhe të cilat janë shkronjat e para të fjalëve vijuese të renditura në formë vjershe:

صَفَ ذَا ثَنَا كَمْ جَادَ شَخْصٌ قَدْ سَمَا دُمٌ طَيِّبًا زِدْ فِي ثَقَى
ضَعُ ظَالِمًا

Shembuj:

يَنْصُرُكُمْ، مَنْ ذَا الَّذِي، مِنْ ثَمَرَةٍ، مَنْ كَانَ، وَأَنْجَيْنَا،
فَمَنْ شَهِدَ، مِنْ قَبْلُ، مَا تَنْسَخُ، عِنْدَهُ، مِنْ طِينٍ مَنْ
زَكَاها، لِيُنْفِقَ، كُنْتُمْ، فَانْظُرُوا،
قِسْمَةَ ضِيْزَى، جَنَّتِ تَجْرِي، مِنْ كَأْسٍ كَانَ،
ظِلًّا ظَلِيلًا، خَالِدًا فِيْهَا، فَوَجَّ سَأَلَهُمْ،

Arsyeja e ihfas: Nuni dhe tenvinët fshihen para këtyre shkronjave sepse ato nuk janë afruar me ato shkronja sikurse me shkronjat e Idgamit, po ashtu nuk janë larguar aq shumë si shkronjat e Idhharit, kështu që marrin një dispozitë mesatare në mes Idhharit dhe Idgamit, e që është Ihfaja.

Kategoritë e Ihfasë:

- 1 - Më e larta është te shkronjat: Ta, Dal dhe Taun (e lehtë).
- 2 - Më e ulta është te shkronjat: Kaf (e rëndë) dhe Kaf.
- 3 - Kurse mesatarja është te shkronjat e tjera.

Dallimi në mes Ihfasë dhe Idgamit: Idgami ka teshdid, ndërsa Ihfaja nuk ka teshdid, Ihfaja ndodh para shkronjave, kurse Idgami ndodh në shkronja. All-llahu e di më së miri!

DISPOZITAT E MIMIT ME SUKUN

أَحْكَامُ الْمِيمِ السَّائِنَةِ (م)

DISPOZITAT E MIMIT ME SUKUN

أَحْكَامُ الْمِيمِ السَّائِنَةِ (م)

Mimi me sukun pavarësisht a është në mes të fjalës apo në fund, i ka tri dispozita:

1- Idgam إِدْغَامُ

2- Ihfa إِيْحْفَاءُ

3- Idhhar إِيْظْهَارُ , dhe secila prej tyre quhet shefevij شَفَوِيّ

1- IDGAMI I MIMIT ME SUKUN - إِدْغَامُ الْمِيمِ السَّائِنَةِ

Ndodh atëherë kur: pas Mimit me sukun vjen e njëjta shkronjë "Mim" الْمِيمُ me vokal.

P.sh.: أَمْ مَنْ، كَمْ مِنْ dhe ky idgam gjithmonë shoqërohet me gun-ne أَمْ مَنْ، كَمْ مَنْ .

2- IHFAJA E MIMIT ME SUKUN - إِيْحْفَاءُ الْمِيمِ السَّائِنَةِ

Ndodh atëherë kur: pas Mimit me sukun vjen shkronja "Ba" الْبَاءُ me vokal.

P.sh.: إِنْ رَبَّهُمْ بِهِمْ، هُمْ بَارِزُونَ

Arsyeja e Ihfas: bashkimi i tyre (Mimit dhe Ba-së) në dalje dhe ngjashmërisë në disa raste(cilësi).

3- IDHHARI I MIMIT ME SUKUN- إِيْظْهَارُ الْمِيمِ السَّائِنَةِ

Ndodh atëherë kur: pas Mimit me sukun vijnë shkronjat e tjera, p.sh:

لَهُمْ فِيهَا، إِنْكُمْ وَمَا تَعْبُدُونَ، تُمْسُونَ، أَنْعَمْتَ، مَتْلَهُمْ كَمَثَلِ

DISPOZITAT E SHKRONJËS “RA” DHE TE SHKRONJËS “LAM”

أَحْكَامُ الرَّاءِ وَاللَّامِ

DISPOZITA E SHKRONJËS RA

أَحْكَامُ الرَّاءِ

Shkronja ra ر gjatë shkrimit vjen ose:

1. E vokalizuar me u-damme - ضَمَّةُ ose e-fet'ha فَتْحَةٌ - ose me l-kesre - كَسْرَةٌ
2. E pavokalizuar me sakin سُكُونٌ - mbas vokalit u-dame ose e-fet'ha ose l-kesra -
3. Në fillim të fjalës, në mes (të fjalës) ose në fund të fjalës. Shkronja ra ر në të gjitha këto pozita ose gjendje l ka dy dispozita: tefhimin التَّفْهِيمُ dhe terkikun التَّرْكِيقُ .

Fjala tefhim do të thotë: me trash shkronjën ra ر duke e ngritur gjuhën lart. Ndërsa fjala terkik do të thotë shqiptim l shkronjës ra ر të lehtë, të holluar dhe duke e ulur gjuhën poshtë.

* RAJA الرَّاءُ bëhet tefhim التَّفْهِيمُ atëherë kur:

- a. ashtë e vokalizuar me u-damme - , ose e-fet'ha - , pavarësisht a është në fillim të fjalës, në mes, apo në fund të saj. P.sh.:

رَبِّمَا، عَرَبًا، يَحْشُرُ رَحِيمًا، خَرَجُوا، صَبَرُ.

- b. kur është e pavokalizuar pra me sukun - pas fet'hes - ose dames - , pavarësisht nëse është në mes të fjalës apo në fund të saj. P.sh.:

الْقُرْآنُ، الْعَرْشُ، تَنْهَرُ

* RAJA الرَّاءُ bëhet terkik التَّرْكِيقُ atëherë

- a. kur është e vokalizuar me-i- kesre - , pavarësisht a është në fillim të fjalës, në mes të saj apo në fund, p.sh. قَرِيبٌ، وَالْفَجْرُ

b. kur është e pavokalizuar pra me sukun - ُ pas kesres - ِ ose shkronjës "ja" الياء p.sh;
مُقْتَدِرٌ، الطَّيْرُ

DISPOZITA E SHKRONJËS LAM

أحكام اللام

Shkronja "LAM" اللام ka katër dispozita : tefhimin التَّفْهِيمُ, terkikin التَّرْكِيقُ, idhnari الإِظْهَارُ dhe Idgamin الإِدْغَامُ .

* Sa i përket tefhimit التَّفْهِيمُ dhe terkikut التَّرْكِيقُ themi se: Esenca në ل lam është terkiku, pra e butë, e lehtë, se edhe vetë është shkronjë e lehtë dhe nuk bëhet tefhim vetëm atëherë kur të vijë në emrin e All-llahut xh.sh (الله) dhe e kemi në dy raste:

a) kur të vijë pas fet'hës - َ p.sh: قَالَ اللهُ

b) kur të vijë pas damës - ُ p.sh: يَقُولُ اللهُ

E nëse qëndron para këtij lami, (këtij përdorimi) kesre - ِ atëherë gjithsesi bëhet terkik (e butë) pavarësisht a është kesrja e ngjitur me të apo e ndarë, p.sh: لِلَّهِ , بِسْمِ اللَّهِ .

*Ndërsa Idh'hari الإِظْهَارُ dhe Idgami الإِدْغَامُ përdoren ose vjen parasysh kur (ال) hyn në të gjitha fjalët e tjera jashtë emrit të All-llahut (الله), për këtë themi se:

IDHHARI الإِظْهَارُ i Lamit اللام ndodh atëherë kur:- ال vjen pas saj një prej katërmbëdhjetë shkronjave

إِنِّعَ حَجَّكَ وَخَفَّ عَقِيمَهُ në këtë rast shkronjën - ل - e shqipton ashtu siç është por me sukun - ُ p.sh.: الْقَمَرُ، الْعَلِيمُ، الْخَبِيرُ، الْعَرْشُ، الْإِيمَانُ، الْقَوْلُ etj.

Ky Lam quhet Lamu Kamerijje اللَّامُ الْقَمَرِيَّةُ dhe shenja e këtij Lami për tu kuptuar më lehtë është: shkronja e cila pason nuk merr teshdid.

IDGAMI الإِدْغَامُ , në Lam اللام ndodh atëherë kur: - ال - vjen pas saj një prej shkronjave të tjera, jashtë atyre katërmbëdhjetë të përmendura, me këtë rast nuk e shqipton Lamin por e bën idgam në shkronjën që pason dhe quhet "Lami Shemsie" اللَّامُ الشَّمْسِيَّةُ dhe shenja e tij është: shkronja e cila pason vjen me teshdid, p.sh:

الشَّمْسُ، النَّاسُ، الرَّحْمَانُ، الرَّحِيمُ، الطَّامَةُ etj.

ZGJATJET EL-MUDUD

الْمُدُّودُ

ZGJATJA - EL-MEDDU الْمَدُّ

EL-MEDDU në aspektin gjuhësor do të thotë: zgjatje. Ndërsa në aspektin terminologjik do të thotë: zgjatja e zërit me shkronjën e medit.

Meddi apo zgjatja ndodh vetëm në tri shkronja Elif **اَلْاَیْفُ**, me kusht që para saj të shfaqet vokali “e” **ـَـ**; vavi **اَلْوَاوُ**, me kusht që para saj të shfaqet vokali “u” damme **ـُـ**; dhe shkronja Ja **اَلْیَاءُ**, me kusht që para saj të shfaqet vokali “i” -kesren **ـِـ**.

Apo thënë ndryshe, shkronjat e medit janë tri: Elifi, Vavi dhe Jaun, me kusht që të jenë të pavokalizuar. Zgjatja e zërit tek këta meda (zgjatje) është sa dy vokale, gjë e cila numërohet me gishta dhe ky med quhet “Meddun tabii - zgjatim natyror” **اَلْمَدُّ الطَّبِیْعِیُّ**

Si p.sh: **قَالَ، قِيلَ، يَقُولُ** kur ta shqiptosh e zgjat vokalin “u” para shkronjës Vav të pavokalizuar, e zgjatë vokalin “i” para shkronjës Ja të pavokalizuar dhe e zgjat vokalin “e” para shkronjës Elif të pavokalizuar.

*Thamë se zgjatja e natyrshme (meddun tabii) bëhet sa dy shkronja, por kjo është e tillë nëse nuk vjen pas shkronjës së zgjatur ndonjë arsye tjetër e cila na obligon të dalim prej zgjatimit natyror në atë jonatyror.

Për atë themi se: Nëse vjen pas shkronjës së zgjatur Hemzja **اَلْهَمْزَةُ - ۛ**, ose sukuni **اَلسُّكُونُ - ۞**, atëherë del prej meddit tabii (natyror), që është bazë, në atë “ferij” (sekondar) **اَلْمَدُّ الْفَرَعِیُّ**, dhe ky medd është disa lloje sipas pozitës së Hemzës dhe Sukunit:

HEMZJA ء - الهمزة

Hemzja vjen pas harfi meddit (shkronjës së zgjatur) në të njëjtën fjalë, ose në fjalën tjetër, dhe secila prej tyre ka dispozitë të veçantë :

EL-MEDD EL-MUTTESIL المد المتصل

Nëse Hemzja është e ngjitur me harfi meddin në të njëjtën fjalë, atëherë quhet el-medd el-muttesil **المد المتصل** (zgjatimi i ngjitur), pra hemzja e ngjitur me harfi meddin në të njëjtën fjalë p.sh:

السوء، جيء، جاء

Ky medd është obligativ të zgjatet prej katër toneve deri në pesë dhe nuk lejohet të jetë më i shkurtër.

Vërejtje: nëse shfaqen dy apo më tepër këso zgjatime në të njëjtin ajet, duhet të zgjaten në mënyrë të barabartë, e jo një të zgjatet më tepër e tjetri më pak.

EL-MEDDI EL-MUNFESIL المد المنفصل

Nëse Hemzja vjen pas harfi meddit, por nuk është e ngjitur me të në të njëjtën fjalë por është në fjalën tjetër, pra e ndarë, atëherë ky medd quhet el-medd el-munfesil **المد المنفصل** (zgjatimi i ndarë), pra jo i bashkuar në të njëjtën fjalë, si p.sh:

، ادعوني أستجب لكم، قوا أنفسكم، إنا أوحينا

Zgjatja e tij bëhet katër deri në pesë tone, por lejohet të zgjatet vetëm dy tone, sepse ky zgjatim është i lejuar e nuk është obligativ.

Vërejtje: nëse shfaqen dy apo më tepër këso zgjatime në të njëjtin ajet, atëherë ata duhet të zgjaten në mënyrë të barabartë, e jo një më shumë e tjetri më pak.

SUKUNI السكون

Sukuni kur vjen pas harfi meddit, atëherë prej meddit tabii kalon në el-medd el-lazim (zgjatim i detyruar) **المد اللازم**.

EL-MEDDI EL-LAZIM المد اللازم

El-Medd el-lazim do të thotë: zgjatim i ngjitur apo i obliguar. Është fjala kur sukuni është pjesë e asaj fjale në çdo gjendje. Sepse kemi sukun i cili vjen vetëm kur të ndalemi e që do të flasim për të pak më vonë.

El-Medd el-lazim është katër lloje:

1- El-Medd el-lazim el-kelimij el-muthekkal

المد اللازم الكلمي المتكلم (zgjatim i obliguar në fjalë, pra i rëndë) e që ndodh: kur pas harfi meddit (shkronjës së zgjatur) vjen sukuni i shoqëruar me teshdid në fjalë, si p.sh:

أَحَاجُّونِي تَأْمُرُونِي، الطَّامَّة، الضَّالِّين

Quhet kelimij- në fjalë: sepse ai ndodh në fjalë e jo në shkronja. Quhet muthekal - i rëndë - sepse është rëndë për ta shqiptuar për shkak që sukuni është me teshdid.

Shtrohet pyetja se ku është sukuni në

(الضَّالِّين والطَّامَّة), përgjigjja është se: shkronja me teshdid gjithmonë është e përbërë prej dy shkronjave, e që e para gjithmonë është me sukun, ndërsa e dyta e vokalizuar, p.sh. shkronja **ل** në fjalën **الضَّالِّين** është me teshdid, e që është e përbërë prej dy lamave ,

lami i parë është me sukun, ndërsa lami i dytë është me kesre الضَّالِّين .

E njëjta gjë është edhe te shkronja Mim م në الطَّامَّةَ , Mimi i parë është me sukun ndërsa i dyti me fet'ha الطَّامَّةَ , e kështu me radhë.

2 - El-Medd el-lazim el-kelimij el-muhaffef

الْمَدُّ اللَّازِمُ الْكَلِمِيِّ الْمُخَفَّفُ (zgjatimi i obliguar në fjalë, i lehtë) e që ndodh: kur pas harfi meddit (shkronjës së zgjatur) vjen sukuni, por jo i shoqëruar me teshdid, në fjalë. E që nuk është shfaqur në Kur'an vetëm në fjalën ءَالَانَ në dy vende në suren Junus:

ءَالَانَ وَقَدْ عَصَيْتَ قَبْلُ وَكُنْتَ مِنَ الْمُفْسِدِينَ.
ءَالَانَ وَقَدْ كُنْتُمْ بِهِ تَسْتَعْجِلُونَ

Quhet kelimij- në fjalë: sepse ai ndodh në fjalë e jo në shkronjë.

Quhet muhafef- i lehtë: sepse është lehtë për t'u shqiptuar sepse nuk ka as teshdid e as gune.

3 - El-Medd el-lazim el-harfij el-muthekkal

الْمَدُّ اللَّازِمُ الْحَرْفِيُّ الْمُتَقَلِّ (zgjatimi i obliguar në shkronjë, i rëndë) e që ndodh: kur pas harfi medit vjen sukuni i shoqëruar me teshdid në shkronjë e jo në fjalë.

Dhe këtë e hasim në el-huruf el-mukattaa

الحُرُوفُ الْمُقَطَّعَةُ në shkronja të ndërprera që shfaqen në fillim të disa sureve p.sh. أَلَمْ، أَلَمْ. Në shembullin e parë gjatë shqiptimit të Lam-it i cili përfundon me shkronjën Mim, ky Mim shkrihet në Mim-in vijues, pra Elif Laaaaaam-Miiiiim أَلِفْ لَامٌ مِيمٌ. Gjithashtu në

shembullin e dytë Elif laaaaaam Ra أَلِفْ لَامٌ رَا

Quhet harfij-në shkronjë: sepse ai ndodh në shkronjë e jo në fjalë.

Quhet muthekal i rëndë: sepse është i rëndë për ta shqiptuar për shkak se sukuni është me teshdid.

4- El-Medd el-lazim el-harfij el-muhaffef

الْمَدُّ اللَّازِمُ الْحَرْفِيُّ الْمُخَفَّفُ (zgjatimi i obliguar në shkronjë, i lehtë) e që ndodh: kur pas harfi meddit (shkronjës së zgjatur) vjen sukuni, por jo i shoqëruar me teshdid, në shkronjë e jo në fjalë. p.sh.

حَم، يَس، ق، ن

Shqiptimi i këtyre shembujve bëhet kështu: Ha Miiiiim, Ja Siiiiin, Kaaaaaaf, Nuuuuun.

Quhet harfij - në shkronjë: sepse ai ndodh në shkronjë e jo në fjalë.

Quhet muhaffef: sepse është lehtë për tu shqiptuar sepse nuk ka teshdid.

*Pas kësaj themi se: el-medd el-lazim qenka në fjalë ose në shkronjë dhe secila prej tyre ose është e lehtë ose e rëndë. Dhe dispozita e el-medd el-lazim me katër llojet e tij është obligativ dhe zgjatja e tyre bëhet gjashtë tone.

EL-MEDUL-ARID LIS-SUKUN

الْمَدُّ الْعَارِضُ

(zgjatimi gjatë shfaqjes së sukunit rastësor)

E cekëm më lart se: nëse sukuni i cili shfaqet pas harfi meddit, është i qëndrueshëm, pjesë e asaj fjale dhe quhet el-medd el-lazim, por nganjëherë sukuni paraqitet pas harfi meddit vetëm kur të ndalemi, pra nuk është pjesë e fjalës p.sh. الرَّحِيمُ këtu e gjejmë se pas harfi meddit ka ardhur shkronja م me damme (u) por kur të ndalemi, ndalemi me sukun, e në këtë rast e shqiptojmë الرَّحِيمُ, pra ka ardhur sukuni rastësor pas harfi meddit, por nuk është pjesë e fjalës, mirëpo ne kur të ndalemi, ndalemi me sukun, ndërsa kur vazhdojmë, e lexojmë me vokal dhe ky sukun në të cilën ndalemi quhet "el-meddul-arid lis-sukun".

Shembuj të tjerë: يَوْمُ الدِّينِ الْعَالَمِينَ

Dispozita e tij është: të zgjatet dy, katër deri në gjashtë tone dhe është i lejuar e jo i obliguar.

MEDDUL-LIN

مَدُّ اللَّيْنِ

ZGJATIMI I BUTË

Është ai zgjatim kur shkronja e parafundit e fjalës është Vav (و) apo Ja (ي) dhe janë me sukun. Me rastin e ndaljes në këto fjalë ndodh meddul-lin, i cili është zgjatim i lejuar e jo obligativ dhe mund të zgjatet prej dy deri në gjashtë tone, si p.sh:

الصَّيْفُ، رَبِّ، قَرِيشُ، أَتَيْتُ، رَمَيْتُ، بَيْتُ، خَوْفُ

EL BEDEL

الْبَدَلُ

ZËVENDSIMI

P.sh. آدَمُ، أُوتُوا، إِيْمَانًا

Quhet zëvendësim sepse shkronja e medit - zgjatjes vjen në vend të hemzes me sukun e cila është shëndrruar në elif ose vav ose ja

أَلِفًا أَوْ وَاوًا أَوْ يَاءً në fjalët e lartpërmendura, sepse rrënja e tyre është:

أَدَمُ، أُوتُوا، إِيْمَانًا pra janë dy hamze, njëra me vokal ndërsa tjetra me sukun, ajo që është me vokal mbetet ndërsa ajo që është me sukun zhduket duke u shëndrruar në njërin prej tri shkronjave të medit sipas vokalit që ka hemzja e parë.

Dispozita e këtij medi është: të zgjatet dy tone.

HA-ULKINAJE, HEMZETUL-VASLI HEMZETUL-KAT,I

هَاءُ الْكِنَايَةِ وَهَمْزَةُ الْوَصْلِ
وَهَمْزَةُ الْقَطْعِ

HA -ULKINAJE

هَاءُ الْكِنَايَةِ

Është fjala për shkronjën (ha) هـ e cila i dedikohet përëmrut vetor, veta e tretë, numri njëjës (ai).

-Kjo ha هـ i ka katër pozita apo gjendje:

1- Të vijë ose të rrijë mes dy shkronjave të vokalizuar p.sh: **إِنْ كُنْتُمْ مِنْ قَبْلِهِ لَمَنِ الضَّالِّينَ،**
قَالَ لَهُ صَاحِبُهُ وَهُوَ...

Në këtë rast nëse është e vokalizuar me dame “u” ة e lidh me vav و.

E nëse është me kesre “i” ي e lidhë me ja ي , dhe në të dy rastet e zgjat sa dy shkronja përpos në tri fjalë:

- a) **أَرْجَى** Në suren El-A'raf të cilën e lexon me sukun.
- b) **فَالْقَهْ** Në suren En-Neml të cilën e lexon me sukun gjithashtu .
- c) **يَرْضَاهُ لَكُمْ** Në suren Zummer e lexon pa med, pa zgjatje.

2 -Të vijë ose të jetë mes dy sukunave, p.sh

إِلَيْهِ الْمَصِيرُ، تَذَرُوهُ الرِّيحُ në këtë rast nuk zgjatet fare.

3 - Të vijë ose të ndodhet pas vokalit e para sukunit, p.sh: **إِلَيْهِ الْمَصِيرُ , لَهُ الْمُلْكُ** e në këtë rast nuk zgjatet fare.

4 - Të vijë pas sukunit dhe para vokalit p.sh.

فِيهِ هُدًى e në këtë rast gjithashtu nuk zgjatet fare. Përveç një rasti në Kur'an në suren El-Furkan në ajetin 69 ku zanorja e fjalës “fihii” duhet të zgjatet sa dy tone: **وَيَخْلُدُ فِيهِ مُهَانًا**

HEMZETUL-VASLI

هَمْزَةُ الْوَصْلِ

(hemzeja e ngjitur)

Hemzet e ardhura në Kur'an jan dy lloje: hemzetul-vasli (hemzeja e ngjitur) dhe hemzetul-kat'i (hemzeja e ndarë).

Në esencë kjo temë i përket gramatikës në hollësi, por ne na intereson ajo çka na duhet për leximin e Kur'anit me vokal: Nëse e hasim në fillim të fjalës së Kuranit me vokal, e lexojmë fjalën duke filluar me atë

vokal p.sh. ضَرَبَ dhe kjo është e qartë.

Por, nëse fillimi i fjalës është me sukun dhe dëshiron të fillosh prej aty, atëherë duhet ta sjellësh një hemze (ء) të cilën e vokalizon e pastaj e fillon me të, sepse në gjuhën arabe nuk fillohet me sukun. P.sh.

إِهْدِنَا kjo hemze nuk është pjesë e fjalës, por përderisa fjala هِدْنَا fillon me sukun, atëherë detyrimisht duhet ta shtojmë një hemze ا në mënyrë që të mund t'i lexojmë ato duke filluar me vokal, e kjo hemze quhet hemzetul-vasli, që do të thotë hemzeja lidhëse, e cila kur ta lidhësh me fjalën që ka para, bie, nuk lexohet fare, p.sh.

قَالُوا ابْنُوا لَهُبْنَانًا nëse e lexojmë krejt fjalinë atëherë hemzetul-vaslin nuk e lexojmë fare.

Por nëse e fillojmë me fjalën ابْنُوا لَهُ duhet ta lexojmë patjetër.

Është me rëndësi të veçantë ta kuptojmë se kur kjo hemze lexohet me “i” dhe kur me “u”. Pikërisht për këtë arsye themi se: kjo varet prej shkronjës së tretë të foljes në kohën e tashme فَعْلُ الْمُضَارِعِ pra:

1-Nëse shkronja e tretë e foljes në kohën e tashme është me kesre apo me fet'ha, atëherë hemzetul-vaslin e lexon me “i” = kesre, p.sh:

ارْجِعْ، ارْكَبْ، اِهْدِنَا

2 - Në këtë grup hyjnë edhe folje të tilla si p.sh: اسْتَطَاعُوا، اسْطَاعُوا، انْشَقَّتْ، انْشَقَّتُمْ، اِدْرَكُوا، اَطْرَبْنَا etj. Sepse pas një vështirimi e gjen se shkronja e tretë e këtyre foljeve në kohën e tashme është me kesre apo me fet'ha.

3 - Nëse shkronja e tretë e kohës së tashme është me damme “u” = ا، atëherë hamzetul-vaslin e lexon me damme “u” = u p.sh:

اسْتَضَعُوا، اضْطَرَّ، اَوْثَمِنَ، اجْتَنَّتْ، اسْتَهْزَى، اُتِلْ، اُقْتُلُوا

4- Kur vjen me emra fillon me kesre “i” = ا e që ka ardhur në shtatë emra, e ata janë:

ابْنَتَ عِمْرَانَ p.sh. (ابْنَةُ). ابْنُ مَرْيَمَ p.sh. (ابْنُ)

اِمْرَاَتَ نُوحٍ p.sh. (اِمْرَاَةٌ). اِمْرِئُ مِنْهُمْ p.sh. (اِمْرِئُ)

وَلَا تَتَّخِذُوا الْهَيْنَ اثْنَيْنِ p.sh. (اِثْنَيْنِ)

كَانَتَا اِثْنَيْنِ p.sh. (اِثْنَيْنِ)

اِسْمُ رَبِّكَ p.sh. (اِسْمُ)

5 - Kur vjen në paskajore (masdar) fillon me kesre = ا p.sh. اِخْرَاجٌ، اِنْطِلَاقٌ، اِسْتِعْفَارٌ “i”

6 - Kur vjen para “Lamut-tarifat” (Lami i shquarsisë) اَلْ - اللَامُ التَّعْرِيفُ fillon gjithherë me fet'ha = ا p.sh. الرَّحِيمُ، الرَّحْمَانُ، الْعَالَمِينَ، الْحَمْدُ لِلَّهِ

7-Kur vjen hemzetul-istifhami هَمْزَةُ الْإِسْتِفْهَامِ hemzeja pyetëse së bashku me hemzetul-vaslin, atëherë fshihet hemzetul-vasli dhe e lexon me fet'ha - hemzetu istifhamin, e që ka ardhur në shtatë vende në Kur'an قُلْ أَتَّخَذْتُمْ عِنْدَ اللَّهِ عَهْدًا

أَفْتَرَىٰ عَلَى اللَّهِ كَذِبًا (Merjem), أَطَّلَعَ الْغَيْبَ (El-Bekare), أَتَّخَذْتُمْ سُخْرِيًّا (Saffat), أَصْطَفَىٰ الْبَنَاتِ (Sebe'), أَتَّخَذْتُمْ أُسْتَكْبَرْتَ أَمْ كُنْتَ مِنَ الْعَالِينَ (Sad), أَتَّخَذْتُمْ أُسْتَعْفَرْتَ لَهُمْ أَمْ لَمْ تَسْتَغْفِرْ لَهُمْ (Munafikun).

Sepse rrënja e këtyre fjalëve është, أَتَّخَذْتُمْ, أَطَّلَعَ, أَفْتَرَىٰ, أَصْطَفَىٰ, أُسْتَكْبَرْتَ, أُسْتَعْفَرْتَ

8- Kur të bashkohet hemzetu istifhami me hemzetul-vaslin në një fjalë dhe vjen pas hemzetul-vaslit, Lami اللام, atëherë mbetet hemzetul-vasli nuk fshihet, por nuk lexohet dhe shëndrrohet në -آ- elif me medd, e kjo ka ardhur në gjashtë vende në Kur'an:

عَالَمَانَ në dy vende në suren El-En'am. عَالَمَانَ në dy vende në suren Junus. عَالَمَانَ أَيْنَ لَكُمْ në suren Junus. عَالَمَانَ خَيْرٌ أَمْ يَشْرِكُونَ në suren En-Neml.

HEMZETUL- KAT'I

هَمْزَةُ الْقَطْعِ

(hemzeja e ndarë)

Përballë hemzetul-vaslit e kemi hemzetul-kat'in (hemzeja e ndarë), quhet e ndarë sepse i ndan shkronjat mes vete, përderisa hemzetul-vasli i lidh mes vete. Kjo hemze gjithmonë shkruhet dhe lexohet, pamvarsisht a e lidh me fjalën që e ka para, apo fillon me të. Pra kjo hemze është pjesë e fjalës, duhet të lexohet patjetër.

Mundë të vie në fillim të fjalës, pamvarsishtë a është me fetha — psh (أَعْطَيْنَاكَ), ose me kesre — (إِنَّا), ose me dame — (أُوتُوا). Ndërsa me sukun — nuk vie fare sepse fjala në arabishte siç kuptuam më herët nuk fillon me sukun.

Siç vie në mes të fjalës, pamvarsishtë a është me fetha — (فُرْعَانُ), apo me kesre — (سُبُلَاتُ), apo me dame — (وَبْنَرُ), (الْمَوْءُودَةُ), apo me sukun — (وَبْنَرُ).

Siç vie në fund të fjalës, pamvarsishtë a është me fetha — (جَاءَ), apo me kesre — (قُرُوعٍ), apo me dame — (نَشَأُ), (يَسْتَهْزِئُ), apo me sukun — (نَشَأُ).

Siç e pamë kjo hemze vie në emra, folje dhe shkronja.

DISA VEÇORI TE SHKRONJAVE

بَعْضُ صِفَاتِ الْحُرُوفِ

Çdo shkronjë ka cilësi apo veçori me të cilat dallohet nga shkronjat e tjera. Dhe prej cilësive më të rëndësishme janë:

E FORTË DHE E BUTË

الشَّدَّةُ وَالرَّخَاوَةُ

E fortë do të thotë: ta ndalësh zërin në tu gjat shqiptimit, p.sh. kur të thuash: (أَجْ), (أَدْ), (أَفْ), (أَبْ), (أُتْ), dhe këto shkronja janë të forta, të përmbledhura në fjalën : (أَجِدْ قَطْ بَكَتْ). Ndërsa shkronjat e tjera janë të buta, që do të thotë nuk e ndal zërin në tu gjat shqiptimit por, vazhdon zëri edhe më tej. P.sh. (أُسْ), (أُلْ), (أَمْ), (أُتْ), dhe kështu me radhë edhe shkronjat e tjera.

TRASHJA DHE HOLLËSIMI

الِاسْتِعْلَاءُ وَالِاسْتِفَالُ

Trashja do të thotë: ta trashësh shkronjën kur ta shqiptosh p.sh. (أَط), (أَغ), (أَض), (أَص), (أَخ), gjatë shqiptimit të këtyre shkronjave obligohesh që ta trashësh zërin duke e ngritur gjuhën lart.

Shkronjat e trasha janë të përmbledhura në fjalën (خَصَّ ضَغْطٍ قِظ).

Ndërsa kur të thuash: (أَل), (أُس), (أَد), (أُح), (أُك), dhe shkronja të tjera. Obligohesh që ta hollosh dhe zbutur zërin duke e ulur gjuhën poshtë.

PËRSËRITJA

التَّكْرَارُ

Përsëritja është lëvizja e majës së gjuhës, dhe kjo ndodh vetëm në shkronjën -ra- (الرَاء- ر), por nuk përsëritet më shumë se një herë, psh (أُر) dhe me këtë përsëritje shfaqet dallimi mes -ras- الراء dhe shkronjave të tjera.

FISHËLLIMA

الصَّفِيرُ

Nëse thua: (أَص), (أُس), (أَز) do ta dëgjosh një zë shtojcë prej sadit, sinit, dhe zaj, zë i cili i përngjan fishkëllimës. Dhe kjo është vetëm për këto tri shkronja.

KALKALEJA

الْقَلَقَلَةُ

Fjala “kalkale” në etimologji (gjuhësisht) do të thotë: lëvizje, lëkundje apo jostabilitet.

Kurse në këtë rast ose në terminologji do të thotë: lëkundje apo shqiptim i theksuar ose i thekshëm i shkronjave derisa të dëgjohej një ton i fortë. Shkronjat e kalkales janë pesë të përmbledhura në fjalën (قَطَبُ جَدِّ), si p.sh:

حَقٌّ ، لَمْ يَلِدْ ، قِسْطٌ ، تَبَّ ، الْحَجُّ

Në të gjitha këto vende dhe të ngjashme, shkronjat e kalkales duhet të jenë shumë të theksueshme kur ato janë me sukun apo kur të ndalemi në to, ku me këtë rast fitojnë sukunin. Dhe mund të thuhet se atyre u shtohet një “ë” e theksueshme.

Kalkaleja ndodh edhe nëse shkronja e kalkales me sukun është në mes të fjalës p.sh: فَاغْلُوهُمْ .

Kategoritë e Kalkales: më e larta është te shkronja e kalkales me teshdid në të cilën ndalemi, psh (الْحَقُّ), më pas vjen shkronja me sukun në të cilën ndalemi, psh (خَلَقُ), si dhe më pas në shkronjën me sukun në të cilën nuk ndalemi, (خَلَقْنَا) .

MIMI DHE NUNI ME TESHDID

الْمِيمُ وَالنُّونُ الْمُشَدَّدَتَيْنِ

Nuni dhe Mimi kur të vijnë me teshdid, dispozita e tyre është të shqiptohet me gunne dhe atë sa për dy shkronja: P.sh.:

جَهَنَّمَ، لَمَّا، الْجَنَّةُ، النَّاسُ، ثُمَّ، إِنَّ، مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ

dhe mund të vijnë në mes të fjalisë dhe në fund.

TË NDALURIT GJATË LEXIMIT TË KURANIT DHE SHENJAT E NDALJES

الْوَقْفُ وَعَلَامَاتُهُ

EL-VAKF

الْوَقْفُ

TË NDALURIT GJATË LEXIMIT TË KUR'ANIT

Vakfi është ndalje gjatë leximit të Kur'anit zakonisht për të marrë frymë.

- Syntet është që të ndalesh në fund të çdo ajeti, të marrësh frymë e pastaj të vazhdosh ajetin tjetër, kështu ka vepruar Pejgamberi alejhis-selam. Ai ka lexuar ajetin, p.sh. ka lexuar

الحمد لله رب العالمين e pastaj është ndalur,

مالك يوم الدين ka ndaluar përsëri الرحمن الرحيم, por nuk prish punë edhe lidhësh ma shumë se një ajet me një frymarrje. Dhe kjo s'është problem, por ndodhë që ajeti të jetë i gjatë, atëherë nuk ke mundësi për ta lexuar ajetin deri në fund me një frymëmarrje pa u ndalur fare, për atë shkak duhet patjetër të ndalesh në mes të ajeteve dhe atëherë duhet të kemi disa pika parasysh:

1-Të jetë kuptimi i plotë në fjalën në të cilën je ndalur, p.sh:

هُوَ الْحَيُّ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ فَادْعُوهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ.

الحمد لله رب العالمين

Nëse ndalesh në këtë rast në fjalën له atëherë është lexim i rregullt, sepse kuptimi është i plotë dhe ajo që pason pas saj nuk lidhet me të por, është fillim i një domethënie tjetër.

2 - Nëse ndalesh në ndonjë fjalë dhe kuptimi i asaj që pason është i lidhur me kuptimin e fjalisë para ndaljes, atëherë, nuk fillon prej ku je ndalur por, kthehesh mbrapa në një apo dy fjalë apo aq sa ka nevojë për ta plotësuar kuptimin p.sh.

الحمد لله është fjali e plotë, por nuk është mirë të fillosh me fjalinë që pason رَبِّ الْعَالَمِينَ. Dhe kjo për arsye se kjo fjali është e lidhur ngushtë me fjalinë e parë dhe në këtë rast e lidh ngushtë me fjalinë e parë ashtu siç e lidh edhe në fjalinë e dytë me të parën, pra thua الحمد لله رب العالمين

SHENJAT E NDALJES -VAKFIT عَلَامَاتُ الْوَقْفِ

Në çdo Mus'haf gjen shenja të ndryshme mbi shkronja të cilat kanë të bëjnë me ndaljen se ku bën të ndalesh dhe ku nuk bën, ku është më mirë, etj.

Dhe e gjitha kjo në mënyrë që t'i lehtësohet lexuesit, leximi i drejt i Kur'anit.

Në Mus'hafin që është botuar në Medine dhe që është më i përhapuri sot, i gjejmë disa shenja që kanë domethënien e vet:

1- م : Ndalesë e domosdoshme: në këtë shenjë duhet të ndalemi që të arrihet kuptimi i ajetit, sepse nëse إِنْ مَّا nuk ndalemi, mund të humbë qëllimi i ajetit يَسْتَجِيبُ الَّذِينَ يَسْمَعُونَ م وَالْمَوْتَى يَبْعَثُهُمُ اللَّهُ.

2- لا : Mos u ndal: te kjo shenjë nuk duhet të ndalemi përveçse nëse e humbim frymën, sepse kuptimi e fjalisë s'është plotësuar ende. Por nëse ndalemi, duhet filluar në dy-tri fjalë më herët p.sh

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ

3- ج : Vazhdimi i leximit apo të ndalurit te kjo shenjë janë të barabartë p.sh:

نَحْنُ نُقْصُ عَلَيْكَ نَبَاهُهم بِالْحَقِّ ۚ إِنَّهُمْ فِتْيَةٌ آمَنُوا بِرَبِّهِمْ

4- قلى : Vazhdimi i leximit është i lejuar, por të ndalurit është më i preferuar, p.sh:

قُلْ رَبِّيَ أَعْلَمُ بِعِدَّتِهِمْ مَا يَعْلَمُهُمْ إِلَّا قَلِيلٌ ۚ فَلَا تُمَارَ فِيهِمْ

5- صلي : Ndalimi është i lejuar, por vazhdimi është më i preferuar, p.sh:

وَإِنْ يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ ۚ وَإِنْ يَمْسَسْكَ بَخِيرٍ فَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

6- .:..: Nëse ndalemi te tri pikat e para, nuk duhet të ndalemi te tri pikat e ardhshme, e nëse nuk ndalemi te tri pikat e para, duhet të ndalemi te tri pikat e dyta, p.sh:

ذَلِكَ الْكِتَابُ لَا رَيْبَ ۚ فِيهِ ۚ هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

SEKTEJA السَّكَّةُ

Fjala "Sekte" gjuhësisht do të thotë: ndërprerje, ndalje, heshtje.

Kurse në terminologji do të thotë: ndërprerje e leximit të Kur'anit, por jo edhe të frymëmarrjes, për një moment të shkurtër dhe pastaj vazhdohet leximi.

Është transmetuar nga Hafsi prej Asimit sekteja në këto vende në Kur'an:

1- Në suren El-Kehf : 1, në fjalën "ivexha", po që se lidhemi me ajetin vijues:

وَلَمْ يَجْعَلْ لَهُ عِوَجًا ۖ قِيَمًا لِّيُنْذِرَ

2- Në suren Jasin : 52, në fjalën "merkadina" në mes të ajetit:

قَالُوا يَا وَيْلَنَا مَنْ بَعَثَنَا مِنْ مَرْقَدِنَا* هَذَا مَا وَعَدَ الرَّحْمَنُ
وَصَدَقَ الْمُرْسَلُونَ

3- Në suren El-Kijame : 27, në fjalën “men rak”:

وَقِيلَ مَنْ رَاقٍ

4- Në suren El-Mutaffifun : 14, në fjalën “bel rane”:

كَلَّا بَلْ رَانَ عَلَى قُلُوبِهِمْ مَا كَانُوا يَكْسِبُونَ

5- Kurse në suren El-Hakka: 28, në fjalën “malijeh * heleke”, sipas tij mund të lexohet në dy mënyra:

مَا أَغْنَىٰ عَنِّي مَالِيَهُ سَ هَلْكَ عَنِّي سُلْطَانِيَهُ

a) fjala “malijeh” të shqiptohet me l dhhar (ashtu si është) dhe me sekte. Dhe kjo është më e preferuar.

b) shkronja e fundit e fjalës “malijeh” e që është shkronja “h” të shkrihet (ldgam) në fjalën “heleke” po qe se i lidhim të dy ajetet.

Shenja e Sektes në Kur'an: shenja e sektes në Kur'anin që është me rregullat e Texhvidit (botimi i Medinës) është një Sin i vogël në vendin e sektes (س) kurse në ata që nuk kanë rregullat e texhvidit mund të kenë poshtë të shkruar me të vogla fjalën “sekte”. Sekteja ndodh: sepse nëse vazhdohet leximi pa sekte, mund të prishë kuptimin, kurse sekteja e shkurtër e largon këtë rrezik.

NJOHURI TË PËRGJITHSHME RRETH KURANIT

Kur'ani i Madhëruar ka zbritur në natën e Kadrit gjatë muajit të Ramazanit dhe këtë na e tregon (siç na tregon) Allahu xh.sh në Kur'an ku thotë :
(شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ)

“Muaji I Ramazanit është ai që në të zbriti Kurani”. Dhe ajeti Kur'anor:

“إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ” Ne e kemi zbritur atë në natën e kadrit” E kjo do të thotë se Kur'ani ka zbritur njëherë komplet në Bejtul-Izze بَيْتُ الْعِزَّةِ në qiellin e dynjasë pastaj I ka zbritur Pejgamberit tonë alejhi selam pak nga pak.

Së pari ajo çka i ka zbritur Pejgamberit

alejhis-selam është اِقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

“Lexo në emër të Zotit tënd, që të ka krijuar”. Ndërsa surja e parë që ka zbritur është surja “El-Muddeththir” سُورَةُ الْمُدَّثِّرِ

Numri i ajeteve të Kur'anit është 6.600 ajete, ndërsa numri i shkronjave të Kur'anit është 323.671, numri i sureve apo kaptinave është 114.

Pejgamberi alejhis-selam përpos që ka ditur Kur'anin përmendësh ka pasur edhe njerëz të posaçëm të cilët janë marrë me shkrimin e Kur'anit. Kështu, ndërsa i zbriste Pejgamberit alejhis-selam Kur'ani, shokët ndërkohë e shënonin nëpër rrasa, lëkura, lëvore të hurmave, etj.

I pari që e ka përmbledhur krejt Kur'anin në një (përmbledhje) libër është Ebu Bekri r.a, pastaj Osmani r.a i cili i ka bërë një përmbledhje të dytë dhe e ka shumuar në gjashtë kopje duke e shpërndarë nëpër qendra islame.

RREGULLA TË LEXIMIT TË KUR'ANIT

Kur të duash të fillosh të lexosh Kur'an, duhet të kërkohej prej Allahut xh.sh që të ruajë prej shejtanit të mallkuar duke thënë:

أَعُوذُ بِاللّٰهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ Allahu xh.sh thotë në Kur'an:

فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللّٰهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ (النحل98) “Dhe kur të duash të lexosh Kur'an, kërko mburojë prej Allahut nga djalli i mallkuar”. Por mund ose bën të thuash edhe:

“Kërkoj mburojë prej Allahut I cili dëgjon dhe di, nga shejtani i mallkuar” sepse Pejgamberi alejhi selam e ka përdorur atë dhe këtë shprehje.

Duhet lexuar bismilahun بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ në fillim të çdo sureje e në veçanti në fillim të sures el-fatiha. Përpos në fillim të sures et-tevbetu e cila fillon pa bismilah.

Ndërsa, nëse fillon për ta lexuar Kur'anin në gjysmë të sureve, atëherë fillon veç me:

أَعُوذُ بِاللّٰهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ por nëse e thua edhe بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيمِ përsëri nuk është gabim.

Po ashtu, obligohet ose është detyrë për ta dëgjuar Kur'anin kur të lexohet dhe duhet të përqendrohesh ose koncentrohesh në të me shumë vëmendje.

Duhet të bëhet përpjekje për zbukurimin e zërit gjatë leximit të Kur'anit, edhe nëse nuk e ke zërin e mirë duhet të përpiqesh ta zbukurosh sa të jetë e mundur. Lidhur me këtë, Pejgamberi alejhis-selam ka thënë:

لَيْسَ مَثًا مَنْ لَمْ يَتَغَنَّ بِالْقُرْآنِ “Nuk është prej nesh ai I cili nuk e zbukuron zërin gjatë leximit të Kuranit”.

Preferohet shfaqja e emocioneve ose të qarit, pra nuk bën ta mbash emocionin fshehur (të qash apo të përpiqesh të qash) gjatë leximit të Kur'anit për të prezantuar madhërinë e Allahut duke paramenduar folësin e këtyre fjalëve që je duke i lexuar.

Preferohet që mos t'i kalojnë muslimanit më shumë se 40 ditë pa e përfunduar një hatme. Është Sunnet që çdo ditë të lexosh Kur'an nga një xhuz por nëse nuk ke mundësi atëherë minimumi 10 ajete në ditë.

Preferohet që kur të përfundosh hatmen të lutesh dhe t'i mbledhësh anëtarët e familjes e të marrin pjesë në këtë dua sepse kjo është prej kohërave kur pranohet lutja - dua.

Kur'anin duhet ta lexosh për hir të Allahut jo për ndonjë qëllim tjetër, është haram që të lexohet Kur'ani për para.

Kjo ishte e tëra ajo çka deshëm ta cekim në këto pak faqe, e lusim Allahun e madhëruar që të na bëjë prej atyre të cilët i japin hakun Kur'anit në lexim por edhe në vepër. Ve sala llahu ala Nebijina Muhamed.

وصلی اللہ علی سیدنا محمد و علی آلہ و صحبہ وسلم

PARATHËNIE	3
NUNI ME SUKUN DHE TENVINI.....	9
IDHHARI	9
IDGAMI	11
IKLABI	12
IHFAJA	13
DISPOZITAT E MIMIT ME SUKUN.....	16
DISPOZITA E SHKRONJËS RA	18
DISPOZITA E SHKRONJËS LAM.....	19
ZGJATJA - EL-MEDDU	22
HEMZJA	23
EL-MEDD EL-MUTTESIL	23
EL-MEDDI EL-MUNFESIL	23
SUKUNI	24
EL-MEDDI EL-LAZIM	24
EL-MEDUL-ARID LIS-SUKUN	27
MEDDUL-LIN	27
EL BEDEL	28
HA -ULKINAJE	30
HEMZETUL-VASLI	31
HEMZETUL- KAT'I.....	33
DISA VEÇORI TE SHKRONJAVE	34
E FORTË DHE E BUTË.....	34
TRASHJA DHE HOLLËSIMI	35
PËRSËRITJA.....	35
FISHËLLIMA	35
KALKALEJA	36
MIMI DHE NUNI ME TESHIDID.....	36
EL-VAKF	38
SHENJAT E NDALJES -VAKFIT	39
SEKTEJA.....	40
NJOHURI TE PERGJITHSHME RRETH KURANIT	42
RREGULLA TË LEXIMIT TE KUR'ANIT	43